

numri 033 | e ejte 23 kallnor 2003 | çmimi 0.50

A po përcaktohen shqiptarët për identitete politike?

SHQIPËRIA ETNIKE E  
ARBËN XHAFERIT

APO KOMBI  
POLITIK I  
TEUTA ARIFIT?

"Moulin Rouge" – Jeton Budima

Ekskluzive: striptizi erdh n'mahallë: GO GO DJALI

# KULTURA

interview

Pamje nga shfaqja "Moulin Rouge"  
me protagonistin Donat Qosja



## 2 FJALË

M. KELMENDI

**MOULIN ROUGE.** Regjisori Jeton Budima, mbas shumë halleve e detyrimeve për me shpjegue çdo skenë e çdo gjest e veprim regjisorial para drejtorit të Teatrit Kombëtar Teki Dervishi, ia doli me e vu në skenë dramën me titull Moulin Rouge. Vetëm tue e pa shfaqjen kuptuem se sa kambëngulës e sa i bindun në veprimet e veta regjisoriale asht Jeton Budima. Se sa shumë ka qenë dasht me e mbrojtë e me e pshtue këte shfaqje prej botëkuptimeve tradicionale e të ngurtësue me të menaxhmentit të Teatrit Kombëtar.

I vendosun dhe i bindun me i luftue konvencionet e veprimet regjisoriale të derisotme në këte teater, ai realizoi dhe vuni në skenë një shfaqje – TJETER.

**TJETËR** në shumë kuptime. E ma së shumti në kuptimin e njoftjes dhe transponimit të shejave dhe kodeve moderne e urbane në këte skenë. Edhe pse teksti ishte i vjeter, bile kisha me thanë i huqun dramaturgjikisht, ajo që u pa dhe na mbeti në mendje ishte – regjia. Jetoni u dëshmue me këte pjesë si njoftës i mirë i teatrit të lëvizjes, teatrit fizik, njashu si edhe e thotë vetë ("për mu teatri s'asht vetëm tekst, por sidomos asht lëvizje"), si njohës i castingut (ndamja e roleve ishte e qëllueme), si shumë koshient për vizualitetin e një shfaqje teatrale, si regjisor që në shfaqje e kallxon 'doren' (në shfaqje del në binë dhe ja jep një shuplakë protagonistit për sjellje të kqija ndaj femnës), si eksperimentues dhe i hapun ndaj procedeve dhe sidomos ndaj teknologjive moderne të teatrit.

**Ajo** që më bani me shkruie asht se ma në fund nga kjo skenë teatri na foli dhe na u drejtue një trupë urbane me gjuhë dhe kode urbane. Dhe, detajet: aktoret e erotizue me çizme me taka e me kambë të gjata, me çorapa najlloni e me korset, me rollera e me biçikleta, me situata jetësore që zakonisht na sillen rreth kloake e kreveti me mbulesa sateni. Mandej kontrapunktet ishin shumë të gjetuna. Detajet: flautistja e veshun me fustan barok, por e ulun në kloakë e me kambët e hapuna njaq sa me t'kallë; femna e gjatë n'kontrapunkt me një femën xhuxhe që shkaktonte një efekt vizual të hatashëm; shorci i bokserave i kombinuem me smoking e me sheshir; drum & bas'i n'kontrapunkt me tingullin e flautës dhe me zanin e shkërdhym të Tom Waitsit tue e rikëndue hitin e madh të grupit Police "Roxane". Nëse duhet me e kualifikue këte shfaqje, kisha me thanë se ky asht një remake. Remake që shkërdhen kanone e rregulla. E për me e kuptue ma sakt se çka jam tue thanë i bie: regjia e Jeton Budimës asht rrafsh si ai remake i hitit "Roxane" nga ana e Tom Waitsit. Ironizim.



Me regjisorin e shfaqjes "Moulin Rouge" – Jeton Budima

## TEATRI SI SPEKTAKËL

Në vazhden e fenomeneve teatrore që ndodhin këtu, kjo shfaqje mund të klasifikohet si tjetër. Ky është një skenim tjetër, ku distanca nga teksti është shumë e madhe dhe faktikisht ekziston një miks i zhanreve dhe stileve, ku fjala p.sh. paraqet vetëm një element kompozicioni, ndërsa pjesa tjetër e informatës bartet përmes gjestit dhe lëvizjes, mandej baletit, pikturës, muzikës "live" edhe krejt kjo e jep idenë dhe përshtypjen e një spektakli

SARA KELMENDI

Jeton Budima, një nga regjisorët e rinj të Prishtinës, po përpiqet që me punën e tij, në mënyrën e vet, t'i thyejë disa rregulla në botën e teatrit kosovar, që ai e quan verbal. Këtë e dëshmon edhe në shfaqjen e tij "Moulin Rouge" të dramaturgut Bertold Brecht, për të cilën kritikët thonë se është e veçantë dhe dalton nga shfaqjet e deritashme kosovare.

**Java: Pse Moulin Rouge?**

**Jeton Budima:** Vepra origjinale e Brehtit quhet "Baal", sipas emrit të personazhit kryesor të kësaj vepre. Por, u bë "Moulin Rouge" për shkak të atmosferës në dhomë që e ka "Baal". "Moulin Rouge" është me motive që për mua kanë qenë interesante, motive nga "Baal" të Bertold Brehtit. Është një tekst i adaptuar ku është ruajtur struktura, vija e ngjarjes që zakonisht quhet, dhe me ndryshime të mëdha në përmbajtje. Inspirimi kryesor për inskenimin e shfaqjes lidhet me figurën e Dionisit, një mbret i ri sipas mitologjisë. Kam lexuar se ai ka qenë biseksual, një mashkull me bukuri të femrës. Unë e kam nxjerrë në skenë, mirëpo me ndryshime të caktuara.

## Java: Sa ka lidhje kjo shfaqje me filmin e famshëm "Moulin Rouge"?

**Jeton Budima:** Ka lidhje vetëm me atmosferë. "Moulin Rouge" është si diçka e kuqe, si diçka që ka shumë atmosferë, përndryshe struktura është krejt tjetër.

## Java: Sa i jeni përmbajtur teksti dhe a është mbindërtim?

**Jeton Budima:** Teksti e ka paraqitur fillimin, ndërsa mbindërtimi është pjesa më e madhe e shfaqjes, për shkak se unë jam një regjisor që nuk kam qejf ta përsëris tekstin, e kjo vlen edhe për aktorë. Për mua, thjesht, teksti e ka paraqitur fillimin, mirëpo jo edhe fundin. Do me thënë ajo pjesa më e madhe e veprimeve që lidhet me tekst e që me karakteret e aktorëve është rindërtim i regjisorit.

## KARAKTERI NË GJEST E JO NË FJALË

### Java: Cili është qëndrimi apo veprimi juaj regjisorial?

**Jeton Budima:** Po edhe "Faust", "Fausti 3" edhe "Moulin Rouge" janë pak a shumë shfaqje specifike, sepse në to dominon teatri i ritualit fizik. Do me thënë edhe këtu si në Faust, 60 për qind e veprimeve janë në lëvizje, e pjesa tjetër i takon tekstit. Pra, teksti paraqet fundin e jo fillimin si ndodh zakonisht në teatrin tonë kosovar. Për mua është shumë me rëndësi nëse karakteri gjendet në gjest e jo në fjalë, që sipas mendimit tim fjala është shpesh rrenë e gjesti është reagimi i parë i emocionit.

### Java: A ju obligon teksti si regjisor?

**Jeton Budima:** Po, gjithsesi, sepse teksti paraqet fazën e parë të punës, do me thënë është fjala për analizën e tekstit dhe përshtypjet e para që nxirren prej tekstit. E tash, gjatë punës tjetër, dy fazat tjera të punës, ku regjisor ka mundësi që gjatë asaj bartjeje në skenë të krijojë distancë prej tekstit. Unë regjisorin shumë shpesh e kuptoj si një lloj ndërmjetësuesi, si një lloj magu që faktikisht e shndërron një gjuhë në gjuhë tjetër, mirëpo edhe në të njëjtën kohë atij i jepet mundësia me qenë autor, për shkak se ndërtim krejt diçka tjetër.

## TEKI DERVISHI - CENSOR

### Java: A keni pasur probleme me menaxhmentin e Teatrit?

**Jeton Budima:** Po këtë herë kam pas problem me drejtorin e Teatrit, Teki Dervishin, i cili fatkeqësisht ndryshe e kupton teatrin sot. Mirëpo, në të njëjtën kohë ai mundohet t'i censurojë disa ide tjera. Problemi ka qenë se këto tema, sipas tij, kanë qenë shumë të forta dhe nuk duhen të shihen në teatër. E, natyrisht unë kam pasur mendim tjetër. Kjo ka qenë pika e mosmarrveshjes tonë. Faktikisht krejt kjo punë tremujore ka ardhur në atë pikë që është dashur të ndërpriten provat për tri ditë, sepse thjesht s'kam qenë i interesuar ta censuroj shfaqjen. Mirëpo, pas disa bisedimeve plotësuese e nxorëm shfaqjen para shikuesve. Prej fillimit unë dhe aktorët kemi vendosur që kjo shfaqje duhet të shihet e jo të censurohet.

### Java: A do ta vlerësonit shfaqjen si TJETËR, si NDRYSHE?

**Jeton Budima:** Në vazhden e fenomeneve teatrore që ndodhin këtu, kjo shfaqje mund të klasifikohet si tjetër. Ky është një skenim tjetër, ku distanca nga teksti është shumë e madhe dhe faktikisht ekziston një miksi i zhanreve dhe stileve, ku fjala p.sh. paraqet vetëm një element

kompozicioni, ndërsa pjesa tjetër e informatës bartet përmes gjestit dhe lëvizjes, mandej baletit, pikturës, muzikës "live" edhe krejt kjo e jep idenë dhe përshtypjen e një spektakli. Pra, me një fjalë, është ikja nga ai tetaër që unë e definoj si – verbal.

### Java: Si do ta definonit, pra, teatrin e derisotëm?

**Jeton Budima:** Si klasik dhe verbal.

### Java: Po ju nga kjo shkollë keni dalë...

**Jeton Budima:** Po kam dalë nga kjo akademi jona. Në këtë akademi mësohen disa principe, e pjesa tjetër i takon regjisorit, autorit, dhe aftësisë së tij për të gjetur dhe mbledhur informata që atij do t'i ndihmonte ta krijonte njëfarë stili. Mst: Për një teatër alternativ

### Java: Teatri jonë e ka humbur publikun?

**Jeton Budima:** Pa dyshim, sepse niveli i teatrit tonë është nivel lokal dhe s'është për t'u çuditur. Po me shfaqje si kjo, ku në parapremierë dhe premierë salla ishte e mbushur, ka shansë publiku edhe të kthehet.

### Java: A po përtërihet trupa teatrore në Kosovë?

**Jeton Budima:** Pa dyshim. Tash është duke u krijuar ajo lidhje mes gjeneratave, e cila ka munguar. Kështu që, faktikisht me disa aktorë të rinj dhe regjisorë të rinj po krijohet kjo lidhje mes gjeneratave që na ka munguar.

### Java: Cilat janë referencat tuaja?

**Jeton Budima:** Inspirimi im i parë në teatër është Antonin Arto, është ai njeriu i cili praktikisht e ka thyer teatrin klasik. Disa principe të Artos mund të identifikohen në shfaqjen "Moulin Rouge", ku Donati ia drejton alltinë publikut, që praktikisht do duhej t'i nxisë disa emocione jo të zakonshme për teatrin, që më herët nuk janë ngacmuar. Pra, Arto dhe Grotovski.

### Java: Ju si regjisorë të rinj, a keni menduar ndonjëherë për një hapësirë teatri alternativ në Prishtinë?

**Jeton Budima:** Paj nëse kjo frymë e sundon Teatrin Kombëtar, atehere by pass'i është i pashmangshëm – ndërtimi i një teatri alternativ, që unë e quaj kamertal, ku temat kanë me qenë të lira, inskenimi por edhe përjetimi i shikuesit ka me qenë tjetër. Ky mund të jetë një plan që lidhet me të nesëmen.

### Java: A keni ambicie për film?

**Jeton Budima:** Plani i parë në këtë lëmi është realizimi i një filmi të metrazhit të shkurtër 30 minutësh me skenar timin dhe Bekim Graiçevcit, por krejt kjo ide gjendet në fazë eksperimentale ku i kemi vënë disa ide në letër. E ka edhe një titull pune "Dhoma e mbyllur" ose "Procesi" dhe ka ngjajshmëri me Kafkën, por natyrisht në një hapësi dhe kohë tjetër. Për diçka më ambicioze as që jam duke menduar.

## KINEMATOGRAFIA KOSOVARE S'EKZISTON

### Java: Çka mendoni për kinematografinë tonë?

**Jeton Budima:** S'kam çka të mendoj, se kinematografia kosovare nuk ekziston, kur e ke parasysh atë vakuim 15 vjeçar që na ndodhi, de fakto kjo kinematografi nuk ekziston më.



Jeton Budima



# URBANIA

Suplementi i java's dedikuem krejt sendeve urbane

## GO GO DJALI

Ekskluzive: striptizi erdh n'mahallë

### URBANIA

Shumë asht folë e përfolë për shfaqjen e Jeton Budimës "Moulin Rouge". Dikujt i ka pëlqye qasja avangarde e regjisorit, dikujt tjetër i asht dokë si kopje e zbehtë e efekteve "tarantineske". Dikujt ju kanë dokë aktorët kosovarë superb n'interpretimin e roleve, dikush asht ankue që nuk kanë rrezatue energjinë e personazheve të definueme në dramën e Bertold Brehtit.

Mirëpo, pakkush nuk pajtohet me një gjë: që party e organizueme mbas shfaqjes në një lokal në qendër të Prishtinës, ka qenë unike për jetën e natës në kryeqytet. Mysafirët e shumtë, të thirrur e të pathirrur, që shkuen në këte party me u zbatimë e me u taku me "stafin realizues" të shfaqjes, gjetën një atmosferë të papame ma heret në kafet dhe club'at e Prishtinës – tanë mbramja u përcollë me vallzime "ekzotike" (medemek striptiz) para publikut gojëhapun. Vll i mbramjes ishte Ardian Selimi – Ardi, striptizeri i parë që performoi në një "mainstream" bar të Prishtinës. Ardi e kall publikun, kamerat e televizioneve ishin të drejtueme vetëm kah ai, çikat fishklloshin, djemtë s'dishin qysh me reagu, por tanë u pajtuen se Ardi asht kah luen si – profesionist i vërtetë.

Për shkak të pamjes dhe veshmbathjes pak feminile, Ardi ka pasë probleme n'Kosovë. Mbasi u kthye nga Gjermania, e patën reh dajak n'Prishtinë, sepse dikujt s'i pat pëlqy qysh po doket. E shajnë tue i thanë se asht "banal. Gay, drogërash, peder, pis, i fliqitë, i pamoralshëm, pa marre". Ndërsa, Ardi thotë "marre asht me vjedhe e me vra, e jo me vallzue." Nga muhabet që e bamë me striptizerin kosovar, një gjë e kishim veçue. Kërkesën e tij që mos me ja cenu lirinë e tij. Ardi, në party'n e organizueme mbas shfaqjes "Moulin Rouge", e ka ba një luftë të guximshme qashtu qysh ka dajtë – për lirinë fundamentale të shprehjes së lirë - tue ba striptiz. Me fjalët e tij:

"Une e du shumë ndjenjen e lirisë, ndjenjen me zgjedh vetë se çka du me ba."

**Urbania: Ardian, po ja nisim me natën "famoze". Qysh t'u dokë me performue "vallzim ekzotik" për herë të parë para publikut prishtinas?**

**Ardian Selimi:** Shumë mirë, valla. Ka qenë një atmosferë papritshëm e mirë, sidomos nga shkaku se gjithë kam andrru me kcy n'Prishtinë, para publiku tem. Reaksionet kanë qenë shumë të mira dhe njerëzit m'kanë pritë shumë mirë. Bile, muj me thanë se deri me sot s'kam pasë hala reagime negative. Thjeshtë, s'e kam pritë që kam me kalu një natë qaq të mirë.

**Urbania: Qysh t'erdh oferta me vallzue në party mbas shfaqjes?**

**A.S.:** Ideja s'ka qenë e jemja, po e një profesoreshe t'Akademisë së Arteve, e cila ka qenë tue e udhëheq artin n'Moulin Rouge. Une as që e kam pritë një ftesë të tillë, po mbasi që m'thirrën, mezi prita me u ekspozue para tyne.

**Urbania: A pate tremë para tanë atyne njerëzve, edhe a u tute mos po ndërhyt dikush fizikisht?**

**A.S.:** Pata edhe tutë edhe tremë. Nën një, sepse s'dijsha qysh kanë me qenë

reagimet e njerëzve; nën dy, jam tutë që dikush ka me më rreh edhe fizikisht. E di, që ndoshta dikujna s'i pëlqen çka baj... dukem edhe pak ekstravagant. Ka njerëz që nuk e pelejne që ky segment i shoqisë perëndimore ka ardhë edhe te na. Derisa jashtë Kosove, vallzime të tilla janë të zakonshme, na shqiptarët ende po kemi vështirësi me i pranue do kënaqësi të tilla. Mendimi jem asht që në mënyrë të qartë me spjegue që çka boj unë nuk asht diqka unikate. Asht send i zakonshëm në botë. Nuk ka lidhje me moralitet a amoralitet. Asht vallzim i cili në diskoteka të jashtme asht formë e zakonshme e argetimit. Për mu e pamoralshme asht marrja e drogës, hajnia, vrasja, prostitucioni e sidomos mungesa e respektit mes njani tjetrit. Fakti që une kam qejf me ba qejf, fakti që une kam qejf me kcye në mënyrë pak ma të veçantë për me e kallë publikun, nuk më ban mu t'amoralshëm.

**Urbania: Komentet e njerëzve që t'kanë pa ishin pozitive. Tanë u pajtuen që po kcejsh "profi". A ke ba punë të tillë edhe dikund tjetër?**

**A.S.:** Edhe n'Gjermani e kam ba këte

punë. Në Gjermani kam punu katër vjet në Go-Go bare të ndryshme. Kjo punë më bjenë shumë kënaqësi, po definitivisht e konsideroj edhe si formë arti...

**Urbania: Nuk po ke reperkusione prej familjes? Puna jote s'asht bash çka baba andërron për djalin e vet?**

**A.S.:** Familja në fillim ka qenë shumë kundër, por ma vonë filluen me e respektu çka baj. Babi m'ka jep ma së



# GO GO DJALI

## Vazhdon prej ballinës

pakti përkrahje. Babi jem m'thojke që "këto sende" s'janë normale, "janë marre". S'e kam pritë prej prindëve këte reaktion, po si duket koha po e bajka të veten. Në moshën e rinisë të tyre s'ka pasë gjana të tilla edhe ata tash s'po dijne qysh me reagu. Por, së paku vllau i madh m'ka jep një përkrahje të jashtëzakonshme. Shpesh ka ardhë edhe me më mbrojtë si një bodyguard i vërtetë.

## Urbana: Çka mendojnë njerëzit për ty?

**A.S.:** Shumica e njerëzve mendojnë që jam një njeri i keq! Banal. Gay. Drogirash. Peder. Pis. I flliqtë. I pamoralshëm. Pa marre. Por muj me thanë se une s'jam asnjani prej këtyne. Jam njeri i thjeshtë, po në Kosovë njerëzit shumë të gjykojnë simbas dukjes edhe pamjes. Une nëse kam qejf me u dokë pak ma ekstravagant se tjerët, ate e kam stil. Une punoj, dal, shkoj në punë, si çdo njeri tjetër. Veç ndoshta thojnë që kam pak ma shumë guxim me ba diçka tjetër e me u marr me sende ma jokonvencionale. Une e du shumë ndjenjën e lirisë, ndjenjën me zgjedh vetë se çka du me ba. Çkado që baj në jetën teme asht punë e jeme. Nuk kanë çka me m'u perzi në jetë personale,

se as une tjerëve nuk ju përzihem qysh e çojnë jetën e tyre.

## Urbana: Nji pyetje për fund, qysh t'u duk nime shfaqja?! A të ka inspiru edhe për performansin tand të mavonshëm?

**A.S.:** Shfaqja ka qenë e mrekullueshme. Diqysh e re - "fresh", që s'asht ba ma herët n'Prishtinë. De facto, bash shfaqja më ka inspiru shumë për me kcy në after-party. Diqysh m'kanë shti me mendu, nëse aktorët e regjisorët kanë pasë guxim me qit një qëso shfaqje në Teatër Kombëtar, pse une, Ardian Selimi, nuk kam guxim me dalë me kcy. Çdo njeri kcen në bara e diskoteka. Vallzimin e kena diqysh në shpirt, s'njoh njeri që s'ka qejf me dridhë pak trupin nën ritëm të muzikës. Une veç shkoj pak ma larg. Më duhet me e shtu edhe një send. Dëshira jeme kryesore asht me i kontribu aq sa mundem që shqiptarët të përparojnë sa ma shumë, që secili njeri me i shpreh ndjenjat e veta. Që njerëzit me e kuptu njani tjetrin. E me hy edhe na n'Europë si çdo popull tjetër. Duhet me pasë guxim edhe m'i toleru njerëzit për sendet që i bajmë. Çkado që ban në jetë nuk asht marre pos krimrit. Çdo gjë tjetër asht zgjedhje personale.

